

VENDIM
Nr.988, datë 1.12.2010

PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme ruan dhe siguron me punonjës të Policisë së Shtetit Bankën e Shqipërisë, degët e saj në rrethe dhe vlerat monetare në lëvizje.
2. Në Policinë e Shtetit krijohet një strukturë e posaçme për ruajtjen dhe sigurimin e Bankës së Shqipërisë, të degëve të saj në rrethe dhe të vlerave monetare në lëvizje.
3. Ministria e Brendshme dhe Banka e Shqipërisë të hartojnë aktmarrëveshje të përbashkët për përcaktimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet tyre.
4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha